

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik , Departamenti i përgjithëshëm, permes gjyqtarit të vetëm gjykues, Shabi Idrizi , asistenten juridike, Shpresa Hoxha, në lëndën penalo- juridike të akuzuarit Z.L nga i akuzuar për veprën penale në vazhdim legalizim i përmbajtjes së rremë nga neni 403 par.1 të KPK-së, sipas Aktakuzës së Prokuroris së Themelore në Ferizaj PP/II.nr. 1111-1/13 të datës 23.10.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqsor-fillestar të hapur më 25.11.2014 në prezencë të Prokurorit shtetror të PTH-Ferizaj Agim Kuka dhe të akuzuarit Z.L, muarr dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari;

Z.L , nga i ati I.dhe e ëma Xh., e gjinis L. ,i lindur më... në, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar prind i 4 fëmijëve, gjendja e varfër ekonomike, pa të dhëna se më parë ka qenë i denuar,përkatisa etnike...shqiptar ,shtetas i Rep.së Kosovës, mbrohet në liri, numri personal ...

Ë S H T Ë F A J T O R

1. me dt. 05.shtator 2012, në intervalin kohor 08:00-16;00 në Gjykatën Komunale në Kaçanik, ka vënë në lajthim organin kompetent, për të vërtetuar një çështje të pa vërtet, e paraparë të shërbej si provë në një çështje ligjore, në atë mënyrë që i pandehuri ka përdorur dokumentin e falsifikuar dhe atë autorizimin me numër UZP 365478/12 të dt. 09.07.2012, kinse të dhenë nga i dëmtuari L.H, me të cilin autorizim ka përpiluar kontratë mbi shitblerjen e palujtshmërisë me K. L., të cilën e ka vërtetuar në Gjykatën Komunale në Kaçanik, me numër 1404/12, pastaj në bazë të kësaj kontrate, parcela kadastrale nr. 129-13,129-7 dhe 130-7, është regjistruar në librat kadastrale në emër të K. L.,

2. me dt. 19 nëtor 2012, në intervalin kohor, 08,00-16,00 në Gjykatën Komunale në Kaçanik, ka vënë në lajthim organin kompentent, për të vërtetuar një çështje të pa vërtet, e paraparë të shërbej si provë në një çështje ligjore, në atë mënyrë që i pandehuri ka përdorur dokumentin e falsifikuar dhe atë autorizimin me numër UZP 365478/12, të dt. 09.07.2012, kinse të dhenë nga i dëmtuari L.H, me të cilin autorizim ka përpiluar kontratë mbi shitblerjen e palujtshmërisë me A. K., të cilën e ka vërtetuar në gjykatën Komunale në Kaçanik me numër 1754/12 pastaj në

bazë të kësaj kontrate, parcela kadastrale nr. 230/6 dhe 282/6, është regjistruar në libratë kadastrale në emër të A.K,

3. me dt. 10 dhjetor 2012, në intervalin kohor, 08:00-16:00, në Gjykatën Komunale në Kaçanik, ka vënë në lajthim organin kompetent, për të vërtetuar një çështje të pa vërtet, e paraparë të shërbej si provë në një çështje ligjore, në atë mënyrë që i pandehuri ka përdorur dokumentin e falsifikuar dhe atë autorizimin me numër UZP 365478/12, të dt. 09.07.2012, kinse të dhenë nga i dëmtuari L.H, me të cilin autorizim ka përpiluar kontratë mbi shitblerjen e paluajtshmëris me M. Sh., të cilën e ka vërtetuar në Gjykatën Komunale në Kaçanik , me numër 1839/12 , pastaj në bazë të kësaj kontrate, parcela kadastrale nr. 955-0 është regjistruar në librat kadastrale në emër të M. Sh.,

4. me dt. 28 dhjetor 2012, në intervalin kohor, 08,00-16;00 në Gjykatën Komunale në Kaçanik, ka vënë në lajthim organin kompetent për të vërtetuar një çështje të pa vërtet , e paraparë të shërben si provë në një çështje ligjore, në atë mënyrë që i pandehuri ka përdorur dokumentin falsifikuar dhe atë autorizimin me numër UZP 365478/12, të dt. 09.07.2012, kinse të dhenë nga i dëmtuari L.H me të cilin autorizim ka përpiluar kontratë mbi shitblerje e palujtshmëris me V. L. të cilën e ka vërtetuar në Gjykatën Komunale në Kaçanik numër 1925/12, pastaj në bazë të kësaj kontrate, parcela kadastrale nr. 888-1 është regjistruar në librat kadastrale në emër të V. L..

5. me dt. 28 dhjetor 2012, në intervalin kohor 08:00-16;00, në Gjykatën Komunale në Kaçanik, ka vënë në lajthim organin kompetent, për të vërtetuar një çështje të pa vërtet, e paraparë të shërbej si provë në një çështje ligjore, në atë mënyrë që i pandehuri ka përdorur dokumentin e falsifikuar dhe atë autorizimin me numër UZP 365478/12 të dt. 09.07.2012, kinse të dhenë nga i dëmtuari L.H, me të cilin autorizim ka përpiluar kontratë mbi shitblerjen e palujtshmërisë me A. G., të cilën e ka vërtetuar në Gjykatën Komunale në Kaçanik, me numër 1922/12, pastaj në bazë të kësaj kontrate, parcela kadastrale nr. 162-1, është regjistruar në librat kadastrale në emër të A. G.

6. me dt. 28. dhjetor , në intervalin kohor 08:00-16,00, në Gjykatën Komunale në Kaçanik, ka vënë në lajthim organin kompetent, për të vërtetuar një çështje të pa vërtet, e paraparë të shërbej si provë në një çështje ligjore, në atë mënyrë që i pandehuri ka përdorur dokumentin e falsifikuar dhe atë autorizimin me numër UZP 365478/12 të dt. 09.07.2012, kinse të dhenë nga i dëmtuari L.H, me të cilin autorizim ka përpiluar kontratë mbi shitblerjen e palujtshmëris me O. D., të cilën e ka vërtetuar në Gjykatën Komunale në Kaçanik, me numër 1927/12, pastaj në

bazë të kësaj kontrate, parcela kadastrale nr. 893-3, 890-4, 891-3, 892-5, 893-5, 895-3 dhe 896-1 janë regjistruar në librat kadastrale në emër të O. D.,

7. me dt. 13 mars 2013, në intervalin kohor 08:00-16, në Gjykatën Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik, ka vënë në lajthim organin kompetent, për të vërtetuar një çështje të pa vërtet, e paraparë të shërbej si provë në një çështje ligjore, në atë mënyrë që i pandehuri ka përdorur dokumentin e falsifikuar dhe atë autorizimin me numër UZP 365478/12 të dt. 09.07.2012, kinse të dhenë nga i dëmtuari L.H, me të cilin autorizim ka përpiluar kontratë mbi shitblerjen e palujtshmërisë me O. D. , të cilën e ka vërtetuar në Gjykatën Komunale në Kaçanik, me numër VR. Nr. 285/13, pastaj në bazë të kësaj kontrate, parcela kadastrale nr. 158-4 dhe 886-3 janë regjistruar në librat kadastrale në emër të O. D.

8. me dt. 13 mars 2013 në intervalin kohor 08:00-16,00 në Gjykatën Themelore në Ferizaj Dega në Kaçanik, ka vënë në lajthim organin kompetent, për të vërtetuar një çështje të pa vërtet, e paraparë të shërbej si provë në një çështje ligjore, në atë mënyrë që i pandehuri ka përdorur dokumentin e falsifikuar dhe atë autorizimin me numër UZP 365478/12 të dt. 09.07.2012, kinse të dhenë nga i dëmtuari L.H, me të cilin autorizim ka përpiluar kontratë mbi shitblerjen e palujtshmërisë me M. L. të cilën e ka vërtetuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj –Dega në Kaçanik , me numër VR.nr. 286/13, pastaj në bazë të kësaj kontrate, parcela kadastrale nr. 134-4 dhe 135-5, janë regjistruar në librat kadastrale në emër të M. L. ,

Me të cilin veprim në vazhdim kreu veprën penale legalizim i përmbajtës së rremë nga nenin 403 par. 1 të KPK.-së.

Andaj duke u bazuar në dispozitën e lartcekur ndeshkimore dhe neneve 2. 11.15, 41, 45, , 75, 76 dhe 81 të KPK-së dhe neneve, 365, 453 , 458 dhe 465 të KPPK-së, e

G J Y K O N

1. Të pandehurin Z.L, e denon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 8 muajëve i cili do ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

2. Anulohen veprimet juridike dhe pasojat e tyre por jo në dëm të palës së tretë-kontratave për shitblerjen e palujtshmërisë të vërtetuara në Gjykatën Komunale në Kaçanik si në vijim; VR.nr.1404/12 e dt. 05.09.2012, VR.nr.1754/12 e dt. 19.11.2012, VR.nr.1839/12 e dt. 10.12.2012, VR.nr. 1925/12 e dt. 28.12.2012, VR.nr.1922/12 e dt. 28.12.2012, VR.nr.1927/12 e dt. 28.12.2012, Vr.nr.285/13 e dt. 13.03.2013 dhe VR.nr.286/13 e dt. 13.03.2013.

3. Urdhëresa për ngrirjen asetëve të lëshuar me dt. 14.08.2014 mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

Udhzohet i dëmtuari që kërkesën pasuroro-juridike ta realizoj në kontest civil

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajnë paushallin gjyqësor në lartësi prej 100.00 euro.

A r s y e t i m

PTH nga Ferizaji, me Aktakuzën .PP/II. nr. 1111-1/2014 të datës 23.10.2013, të akuzuarin Z.L nga ... e ka akuzuar për shkak se në vazhdim ka kryer veprën penale legalizim I përmbajtës së rreme nga neni 403 par.1 të KPK-së .

Në shqyrtimin gjyqsor-fillestar, Prokurori shtetror pranë PTH-Ferizaj Agim Kuka mbeti në tërsi pranë aktit akuzes së paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate, duke propozuar gjykatës që të akuzuarin Z.L të e shpall fajtor për veprën penale që akuzohet dhe ti shqiptohet denim meritor sipas ligjit Njiherit i ka propozuar gjykatës që gjatë matjes së denimit ti ketë parsysh si rrethanat lehtësuese,pranimin e fajsisë pendimin e thellë të tij , dhe si rrethanë rënduese faktin e mira material e cila është sulmuar .

I dëmtuari permes përfaqsesit të tij av. E. Sh. nga.... me parashtrësë të veçantë i është bashkangjitur ndjekës penale dhe ka ushtruar kerkesë pasuroro-juridike.

I akuzuari Z.L në mbrotjen e tij në shqyrtimin gjyqsor-fillestar në tërsi e ka pranuar kryerjen e veprës penale që i vehet në barrë sipas aktit akuzues dhe njiherit është penduar I vjen keq për këtë vepër penale dhe propozon që gjykata të ia shqipton një denim sa më të butë dhe premtion se nuk do perseris kurrë një veprim të tillë.

Pasiqë gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale që i vehet në barrë dhe është e bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare duke u mbshtetur në nenin 248 të KPPK edhe në faktet dhe provat që përmban akti akuzues por edhe ne shkresat e lendes, ka gjetur se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 248 të KPPK-së dhe shqyrtimin gjyqsore e ka përfunduar pa adminstrimin e provave tjera .

Gjykata ka vlersuar se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale legalizim I përmbajtës së rremë nga neni 403 par 1 të KPK-së për të cilën vepër i akuzuari është penalishtë përgjegjës dhe është ndeshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së denimit gjykata i ka pasur parasysht të gjitha rrethanat nga neni 75 i KPK-së të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka marrë për bazë pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit, pendimin e tij, , kurse për bazë për llojin dhe lartsin e denimit ka marrë parashysht se ai më parë nuk ka qenë të gjykuar, efekti do arrihet edhe

më këtë denim, ndërsa rrethanë rënduese se kjo veper penale është e drejtuar kundrejt pronës private të individit që kanë vlera të veqanta shoqrore dhe gëzon mbrojtje ligjore.

Gjykata është e bindur se denimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e përgjegjësise penale të akuzuarit dhe peshën e vepres penale, kështu që denimi i shqiptuar në lartësi si në dispozitiv të aktgjyimit , do arrihet qëllimi i denimit i paraparë me nenin 41 të KPK-së dhe atë efektin rehabilitues dhe pengues tek kryersi, efektin preventiv në mjedis si dhe reagimin shoqror ndaj kësaj dukurie negative dhe të ndeshkushme.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures dhe udhëzimin e pales së dëmtuar është i mbshtetur në dispozitat e nenit 453, 458 dhe 463 e 465 të KPPK-së ,

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P. nr.371/13, me dt. 25.11.2014

Asistentja juridike
Shpresa Hoxha

Gj y q t a r i
Shabi Idrizi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi , pala e paknaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.